



REPUBLIKA E KOSOVËS
KUVENDI I KOMUNËS NË MALISHEVË



Kuvendi i Komunës

Nr. 02/213.

Datë: 05.05.2022

Në bazë të nenit 8, nenit 11, nenit 12 paragrafi 2 pika (d), nenit 17, nenit 24, nenit 40 paragrafi 2 pika c, të Ligjit nr. 03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale "Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës", nr.28/15 qershor 2008", nenit 2 paragrafi 2.1,2.3 të Ligjit Nr.03/L-049 për Financat e Pushtetit Lokal "Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës nr.27/03 qershor 2008", nenit 5 paragrafi 5, nenit 12 paragrafi 3, të Rregullores nr.02/227 datë: 01.07.2020 për ndarjen e Subvencioneve dhe Transfereve, në bazë të nenit 10, nenit 19 paragrafi 7 pika (b), nenit 40, të Statutit të Komunës së Malishevës Nr.01/871 datë:12.11.2008, Kuvendi i Komunës së Malishevës në mbledhjen e mbajtur me datë: 28.04.2022 miraton këtë:

V E N D I M

1. Miratohet kërkesa nr.01/652 datë: 13.08.2021 e parashtruar nga z. Abedin Morina nga fshati Lubizhdë, Komuna e Malishevës për mbështetje financiare, për renovim dhe meremetim të shtëpisë së djegur nga zjarri.

2. Bazuar në pikën 1 të këtij vendimi z. Abedin Morina nga fshati Lubizhdë, i ndahen mjetet financiare në shumën prej 1.500.00€ (njëmijë e pesëqind euro), në emër të ndihmës momentale, për renovim dhe meremetim të shtëpisë së djegur nga zjarri.

2.1. Mjetet ndahen nga kategoria e subvencioneve.

3. Për zbatimin e këtij vendimi kujdeset Kryetari i Komunës, përmes Drejtorisë për Ekonomi, Buxhet dhe Financa.

4. Pas miratimit nga Kuvendi i Komunës së Malishevës, ky vendim hyn në fuqi, sipas nenit 81, të Ligjit nr.03/L-040, për Vetëqeverisjen lokale, si dhe në pajtim me nenin 8 dhe 9 të Rregullores (QRK) nr.10/2019, për shqyrtimin administrativ të akteve të komunave, e ndryshuar dhe plotësuar, me Rregulloren (QRK) nr.06/2021, përkatësisht pas shpalljes në faqen zyrtare të Komunës së Malishevës.

Vendimi ju dërgohet

Arkivit të Komunës

MAPL-së

Drejtorisë për Buxhet dhe Financa.



Kuvendi Komunal Malishevë

Zyresë Kryetarit



PRANUAR ME:

ACCEPTED ON:

PRILJENO:

No. No. Br.

13/08/2021,
01/652

Lenda Kërkesë

UNE ABEDIN MORINA, NR. ID: M000825235, NGA FSHATI LUBIZHDE, KERKON
NGA ZYRA E KRYETARIT NE KK MALISHEVE, QE TE NA NDIHMOJ
NE KOMPENZIMIN E DIMIT, TE SHKARKUAR NGA ZJARRI NE DATE
05.08.2021.

DENET E SHKARKUARA NGA ZJARRI KAPIN VLEREN PREJ 9580 EURO

BASHKANCIJAT ME KERKESJE JANE EDHE RAPORTI I ZJARRIT NGA
DREKTORIA E MBROJTJES DHE SHPETIMIT SI DHE LISTA ME PAKETET
E DUEGURA DHE TE DHEGJUARA NGA ZJARRI.

Malishevë me datën:

13.08.2021

Parashtruesi i Kërkesës

ABEDIN MORINA



Republika e Kosovës

KOMUNA E MALISHEVËS

Drejtoria për Mbrojtje dhe Shpëtim

Sektori I Preventivës ndaj zjarrit dhe Hulumtimit

Nr.i prot. 01/13

Data 05/08/2021

RAPORT I ZJARRIT

Më date 05/08/2021, rreth ores 07:12 jam njoftuar nga Policia e Malishevë se në Lubizhdë është shkaktuar një zjarrë dhe objekti i zjarrit ishte shtëpi banimi.

Në vendin e ngjarjes ishte Shërbimi zjarrëfikësëve, Policia si dhe qytetaret e fshatit ku kanë bërë intervenimin me suksesë dhe po ashtu kanë bere lokalizimin e zjarrit.

Pershkrimi i vendit te ngjarjes ;

Një shtëpi banimi është përfshirë nga zjarri me dimeziona 8.75×8.75, ku nga zjarri janë bërë dëme material, kati i pare është shkaktuar tersishtë nga zjarri, kati i dytë është tymosur nga zjarri, kati i tretë është tymosur nga zjarri, dëmet e tjera kanë qenë të medha, te lënduar ne njerzë nuk kishte sipas deklaratës të pronarit Abedin Morina nga fshati Lubizhdë. .

Shkaktari i zjarrit;

Sipas deklarates të pronarit Abedin Morina shkaktar i zjarrit është xheneratori si pasojë të mbingarkese të nje aparati shlepjake (frigoriferi).

Dëmet material;

Dëmet material te shkaktuar nga zjarri me dt. 05/08/2021 , janë në vlerë mbi 9580.00€, në këtë raport është e bashkangjitur një deklarat e pronarit dhe fotografi nga vendi i ngjarjes.

Pronari :

Abedin Morina

Ofic.Preventivës ndaj zjarrit dhe hulumtimit;

Gani Kryeziu



KUVENDI KOMUNAL NË MALISHEVË

K Ë R E S Ë

Unë Abedin Morina, nr. ID: 1000825235, nga fshati Lubizhdë, kërkoj nga Kuvendi Komunal në Malishevë.

që të n'a ndihmoj në kompensimin e dëmit, të shkaktuar nga zjarri me datë 05.08.2021.

Dëmet e shkaktuara nga zjarri janë si më poshtë:

Nr.	Emri i pajisjes së djegur	Vlera
1	Frigorifer per ftohje	260.00
2	Frigorifer per ngirje	340.00
3	Enëlaresja	240.00
4	Shporeti elektrik	320.00
5	Kuzhina (4m gjatësi)	1200.00
6	Enë dhe suvenire te ndryshme për kuzhinë	700.00
7	Instalimet e rrymës	2000.00
8	Fasadat e mureve të dëmtuara (750m2)	3800.00
9	Dritaret plastike dhe roletat (5 copa, 80cmx100cm)	500.00
10	Dera e drurit 200cmx90cm	220.00
TOTALI		9580.00

Parashtruesi i kërkesës:

Abedin Morina

Datë:09.08.2021







